

KONTRATA E THEMELIMIT TE "ADRION" SHPK.

Themeluesit e Shoqerise "Adrion" Shpk jane ortaket e quajtur :

1. Antonis P. Samaras, Halandri, Athine, Greqi (10 Androutsou Str.)
2. Teodor K. Misha Tirane, Shqiperi, (Rr.Sami Frasheri)
3. Artan M. Meci Tirane, Shqiperi, (Rr Vaso Pasha No. 10)

te cilet vendosen te hartojne kete kontrate per themelimin e nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar sipas rregullave the meposhteme :

Neni 1

Themeluesit themelojne nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin : "ADRION SHPK."

Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne adresen Rruga Sami Frasheri P. 11 Sh. 3 Ap.26 Tirane.
Ortaket mund te krijojne dege ose agjenci ne Shqiperi ose jashte saj sic do ta konsideroje te domosdoshme Shoqeria.

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete 20 (njetete) vjet duke filluar nga dita e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar; ortaket megjithate mund ta zgjasin kete afat ose ta shkrijne shoqerine me pare.

Neni 4

Objekti i shoqerise do te jete :
Importi, eksporti dhe shperndarja e shtypit shqiptar, importi, eksporti dhe shperndarja e shtypit dhe librave te huaj, perfaqesimi dhe shperndarja e mallrave, ndermarrja e studimeve ne lidhje me investimet ne dhe nga Shqiperia, ndermarrja e botimeve te cdo lloji dhe ne cfaredo gjuhe, ndermarrja e aktiviteteve te shtypshkrimit dhe cdo lloj aktiviteti te lidhur me kete si dhe operimi i magazinave te shtypit.

Neni 5

Kapitali themeltar do te jete 100 000 (njqind mije) lek te depozituara ne nje banke shqiptare.
Kapitali themeltar eshte i ndare si vijon :
1. Antonis Samaras 51 (pesedhjete e nje) perqind.
2. Teodor Misha 29 (njetete e nende) perqind.
3. Artan Meci 20 (njetete) perqind, i ndare ne 100 pjese 1 000 leke secila.

Antonis Samaras

Teodor Misha

Artan Meci

Ortakët do të zotërojnë respektivisht:

1. Antonis Samaras 51 pjesë.
2. Teodor Misha 29 pjesë.
3. Artan Meci 20 pjesë.

Kapitali do të rritet sipas vendimit të Asamblesë. Shumica e votave është e domosdoshme.

Neni 6


Vec kësaj kontrate shoqëria do të administrohet sipas rregullave të vendoset në statutin e shoqërisë bashkëngjitur.

Neni 7

Shoqëria do të administrohet nga një administrator. Administratori do të jetë Z. Teodor Misha.

Themeluesit :

Antonis Samaras



Teodor Misha



Artan Meci





REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr 18 Rep

Nr 7 Kol

Tirane, me 2 Dhjetor 1994

VERTETIM

Sot, ne Tirane, me 2 Dhjetor 1994, para meje Noterit Halim Islami u paraqiten personalisht :

1. Antoni P. Samaras, shtetas grek, me pasaporte Nr B 19 5058, banues ne Halandri, Athine (Greqi), 10 Amdroutsou,
2. Teodor Misha, banues ne Tirane, rruga Sami Frasherit, Tirane, me numer pasaporte UG 024080 dhe
3. Artan M. Meci, banues ne Tirane, Rruga Vaso Pasha 10, me numer pasaporte AZ 483474.

Personat e mesiperme jane madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe per identitetin e tyre u sigurova nga pasaportat qe ata mbajne.

Pasi, une Noteri, ua lexova dhe ua shpjegova, Aktin e Themelimit, te Shoqerise bashkangjitur ketij vertetimi, ata me deklaruan se e kuptuan dhe e pranojne dhe se e kane hartuar ate ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire dhe e nenshkruan para meje rregullisht, gje te cilen e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

Halim Islami

Halim Islami



STATUTI I "ADRION" SHPK.

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ADRION Shpk." pasketak e quajtur "Shoqeria" eshte themeluar nga ortaket e meposhtem:

- 1) Antonis P. Samaras, Halandri Athine, Greqi (10 Androutsou Str.)
- 2) Teodor K. Misha , Tirane , Shqiperi (Rr. Sami Frashëri)
- 3) Artan M. Meçi Tiranea , Shqiperi (Rr.Vaso Pasha No.10)

Neni 2

Shoqeria eshte themeluar ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe do te filloje veprimtarite me rregjistrimin ne Rregjistrin Tregtar.

Neni 3

Selia

Selia e shoqerise do te jete gjithmone ne Shqiperi dhe zyra fillestare e rregjistruar do te jete ne adresen Rr Sami Frashëri Pall.11, Shk.III, Ap. 26 Tirane.

Neni 4

Shoqeria do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj ne Shqiperi apo jashte saj.

Neni 5

Libri i Shoqerise

Ne menyre qe te ruhet saktesisht veprimtaria e saj ekonomike dhe marredheniet e punes, Shoqeria do te mbaje nje liber i cili do te quhet Libri i Shoqerise. Te gjithë vendimet e Asamblese se Pergjitheshme te ortakeve do te rregjistrohen ne Librin e Shoqerise.

Neni 6

Fshehtesia

Ortaket dhe te gjithë personat e tjere qe mund te punojne ne Shoqeri pranojne te mos u japin personave te tjere, vendas apo te huaj informacione te disponueshme nga Shoqeria, kontratat e perfunduara nga Shoqeria dhe programet e ardheshme te Shoqerise.

Neni 7

Te gjithë dokumentet dhe aktet e nxjerra nga Shoqeria dhe te adresuara paleve te treta, si mandat arketime, fatura, letra,

Stavros

Corvus

Adamas

njoftime, dhe publikime te ndryshme duhet te tregojne qarte emrin e Shoqerise, pasuar nga fjalet Shpk., kapitalin fillestar dhe emrin e administratorit.

Neni 8

Objekti

Objekti i Shoqerise do te jete :
Importimi, eksportimi dhe shperndarja e shtypit shqiptar, importimi, eksportimi dhe shperndarja e shtypit nderkombetar dhe librave, perfagesimi dhe shperndarja e mallrave, ndermarrja e studimeve njohese ne lidhje me investimet ne Shqiperi dhe nga Shqiperia, ndermarrja e publikimeve te cdo lloji dhe ne cdo lojje gjuhe, ndermarrja e veprimtarive te shtypshkrimit dhe cdo lojje veprimtarie te lidhur me te dhe operimi i magazinave te shtypit.

Neni 9

Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete 20 (njetete) vjet, duke filluar qysh nga data e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar. Por megjithate, ortaket mund te zgjasin kete afat apo te shperndajne Shoqerine para ketij afati.

Neni 10

Kapitali Fillestar

Kapitali fillestar i Shoqerise do te jete 100 000 (njqind mije) leke, te depozituara ne nje banke shqiptare.

Kapitali fillestar ndahet si me poshte:

1. Antonis Samaras 51 (pesedhjete e nje) perqind.
2. Teodor Misha 29 (njetete e nende) perqind.
3. Artan Meçi 20 (njetete) perqind.

i shperndare ne 100 (njqind) pjese me nga 1 000 (njemije) lek secila.

Ortaket do te zoterojne perkatesisht :

1. Antonis Samaras 51 (pesedhjete e nje) pjese
2. Teodor Misha 29 (njetete e nende) pjese
3. Artan Meçi 20 (njetete) pjese.

Kapitali do te rritet sipas vendimit te Asamblese. Shumica e votave eshte e domosdoshme.


Neni 11

Kapitali fillestar mund te transferohet lirisht tek cdo pale e trete sipas nje vendimi te te Asamblese se Pergjitheshme te ortakeve me shumice 3/4 e votave. Pjeset e ortakeve gjithashtu mund te transferohen lirisht ne rast te ndarjes se pasurise ndermjet bashkeshorteve apo ne rastin e trashegimise. Transferimi i kapitalit fillestar duhet te legalizohet nga nje noter publik.

Stane

Amunz

Asanave



Neni 12

Shoqeria do te administrohet nga Z. Teodor Misha. Administratori i Shoqerise duhet te jete kompetent per te administruar veprimtarine e perditeshme te Shoqerise. Ai duhet te perfagesoje Shoqerine prane autoriteteve lokale apo qendrore shqiptare, gjykatave, apo njesive private ose shteterore. Per kontratat qe administratori duhet te pergatis, ai duhet te njoftoje ortaket qe te kete miratimin e tyre. Komunikimi duhet te behet me fax (me shkrim). Pastaj, miratimi jepet me nje leter zyrtare qe ka neneshkrimin e tre ortakeve.

Administratori do te jete pergjegjes perpara Asamblese per cdo marreveshje te bere pa nje miratim te tille.

Neni 13

Asambleja e Pergjitheshme e ortakeve do te miratoje me 3/4 e votave dokumentet financiare te Shoqerise dhe do te vendose me 3/4 e votave per ndryshimet ne Statut, shtimin apo zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, transformimin e Shoqerise si dhe shperndarjen e saj. Gjithashtu Asambleja e Pergjitheshme e ortakeve do te vendose me 3/4 e votave per zgjerimin e veprimtarive te Shoqerise ne kuadrin e objektit te saj. its object.

Neni 14

Asambleja e Pergjitheshme e ortakeve mund te emeruje administrator tjeteter. Ne te tilla raste, emerimi duhet te jete i vlefshem per tre vite financiare, subjekt i doreheqjes apo i largimit. Emerimi behet me shkrim dhe rregjistrohet ne Librin e Shoqerise.

Neni 15

Abandonimi dhe transferimi i pjeseve

Kapitali fillestar mund te transferohet lirisht ndermjet ortakeve nese Asambleja e Pergjitheshme vendos keshtu me 3/4 e votave. Ai gjithashtu mund te transferohet lirisht ne rastet e ndarjes se pasurise ndermjet bashkeshorteve apo ne rast trashegimie.

Transferimi i kapitalit fillestar duhet te legalizohet nga nje noter publik.

Neni 16

Struktura ligjore dhe administrimi i Shoqerise

Zyra e rregjistruar e Shoqerise eshte selia kryesore e saj. Shoqeria mund te hape dege apo agjenci brenda territorit te Shqiperisa ose jashte saj, kur kjo eshte e nevojeshme per te arritur synimet e saj.

Neni 17

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon me

Teodor Misha

Corinus

Abduranf



rregjistrimin ne Rregjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 dhjetor 1994.

Neni 18

Pas miratimit te llogarive, Bilancit financiar dhe percaktimit te fitimeve te Shoqerise dhe zbritjes se rezervave "pro rata" Assambleja e Pergjitheshme e ortakeve percakton fitimin qe i neneshtrohet tatimit. Dividentet do te shperndahen ne perpjestim me perqindjet e pjeseve te ortakeve. Ortaku grek do te kete mundesi ta transferoje fitimin e tij jashte Shqiperise. profit abroad.

Neni 19

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit sic parashikohet ne Ligjin per Shoqerite. Per te ndjekur kete procedure Assambleja e Pergjitheshme cakton nje ose me shume likuidatore, te cilet duhet te raportojne proceduren e likuidimit. Ne perfundim te kesaj procedure Assambleja e Pergjitheshme e ortakeve vendos per Bilancin perfundimtar financiar dhe mbi perfundimin e likuidimit.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Gjykata shqiptare do te jete kompetente per te gjithe mosmarreveshjet e ndeshura gjate ekzistences se Shoqerise apo gjate likuidimit te saj.

Neni 21

Dispozita te Fundit

Ky statut hartohet ne 10 (dhjete) kopje, pese ne anglisht dhe pese ne shqip dhe secila kopje eshte njesoj e vlefshme me te tjerat.

Ortaket e Shoqerise :

Antonis Samaras *ASamaras*

Teodor Misha *T.Misha*

Artan Meçi *Artan Meçi*

Tirane, me 2 dhjetor 1994